



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva Obrazovanja Nauke i  
Tehnologije-Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV  
LEJIMI I AKTIVITETEVE POLITIKE PARTIAKE NË OBJEKTET E  
INSTITUCIONEVE PUBLIKE EDUKATIVE-ARSIMORE DHE AFTËSUESE TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVË**

**NUMËR: 33/2009**

**DATË:14.10.2009**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 42.1 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është lejimi i aktiviteteve politike partiake në objektet e institucioneve publike edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kosovë.

**Neni 2  
Lejimi i aktiviteteve politike**

1. Lejohet mbajtja e aktiviteteve politike partiake parazgjedhore në objektet e institucioneve publike edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kosovë, pas përfundimit të orarit të mësimt.

**Neni 3**  
**Përfshirja e aktiviteteve**


1. Aktiviteti politik përfshin: mbajtjen e çfarëdo mbledhje qoftë, takime, grupe shqyrtuese, rekrutimi i anëtarëve të rinj, demonstrime apo çfarëdo aktiviteti tjetër për qëllime politike partiake.

**Neni 4**  
**Dispozitat shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohen Udhëzimet administrative nr. 14/2002 dhe 15/2002, të cilat e kanë rregulluar këtë çështje.

/ **Neni 5**  
**Hyrja në fuqi**

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e ministrit.

  
**Enver Hoxhaj, ministër**